



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

Nr. 118 prot.

Tiranë, më 13.02.2026

Lënda: Dërgohen tabelat dhe raporti narrativ i monitorimit 12 mujor për vitin 2025

Drejtuar: **MINISTRISË SË TURIZMIT , KULTURËS DHE SPORTIT**
DREJTORISË SË POLITIKAVE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Rruga "Aleksandër Moisiu nr.76 ", Tiranë

Bashkëlidhur po ju dërgojmë plotësimin e tabelave dhe raportin narrativ të monitorimit
12-mujori viti 2025.

Duke ju faleminderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR

Erilda Selaj



Adresa: Rr. "Bulevardi Zogu i I, ndertesa 7, hyrja 4, apartamenti 8, Tirane
Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al

ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të QKVT

Përuena e Raportimit 12-2025

nëlekë

Emri i Grupit		Kodi i grupit									
QENDRA KOMBETARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE TIRANË		1012012									
EMËRTIME		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit									
		Viti parashikues 2024		Përshkrimi raportues		Përshkrimi raportues		Përshkrimi raportues		Përshkrimi raportues	
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Kalkuluar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndrryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Përshkruar Progresive	Struktura e shpenzimeve në %	Ndrryshimi Vjetor (Plan - Fakt)
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (8-3)	(8)	(9)	10 (8-4)
Shpenzimet sipas programeve buxhetore											
Kodi i Programit	Emërtimi										
6220	Aktivitetet të fushës të trashëgimisë kulturore jomatenale	18,032,301.00	100.00%	14,144,000.00	100.00%	14,144,000.00	100.00%	0.00	4,289,888.00	100.00%	8,854,112.00
	Totali i Shpenzimeve buxhetore të Institucionit (Kap 01)	18,032,301.00	100.00%	14,144,000.00	100.00%	14,144,000.00	100.00%	8.88	4,289,888.00	100.00%	8,854,112.00
	Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë Limitit (Kap 04)										
	Totali Shpenzimeve të Shkëlqimit	18,032,301.00	100.00%	14,144,000.00	100.00%	14,144,000.00	100.00%	8.88	4,289,888.00	100.00%	8,854,112.00
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik											
Artikulli	Emërtimi										
600	Paga	7,751,371.00	43.35%	8,700,000.00	47.37%	8,080,000.00	48.23%	1,360,000.00	8,058,885.00	48.88%	3,315.00
601	Sipërmasa Shpenzime	1,290,272.00	8.07%	1,120,000.00	7.92%	1,350,000.00	7.74%	230,000.00	1,342,032.00	7.77%	7,968.00
602	Materia dhe Shërbime të Tjera	1,475,131.00	9.20%	2,000,000.00	14.14%	1,850,000.00	9.46%	-350,000.00	1,548,528.00	8.87%	101,474.00
603	Subvencione							0.00			0.00
604	Transferimi Konante të Brendshme	5,487,527.00	34.29%	4,300,000.00	30.40%	6,300,000.00	38.14%	2,000,000.00	6,288,888.00	38.47%	4,102.00
605	Transferimi Konante të Huaja							0.00			0.00
606	Trans. për Buxh. Fam. & Individ	15,000.00	0.09%	24,000.00	0.17%	74,000.00	0.42%	50,000.00	18,000.00	0.10%	58,000.00
	Non-Totali Shpenzimeve Konante	18,032,301.00	100.00%	14,144,000.00	100.00%	17,434,000.00	100.00%	3,298,888.00	17,381,141.00	100.00%	172,888.00
230	Kapitale të Përpunueshme										
231	Kapitale të Trupëzuara										
	Non-Totali Shpenzimeve Kapitale me financim të brendshëm										
230	Kapitale të Përpunueshme										
231	Kapitale të Trupëzuara										
	Non-Totali Shpenzimeve Kapitale me financim të huaj										
	Totali Shpenzimeve Kapitale										
	Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor	18,032,301.00	1.00	14,144,000.00	1.00	17,434,000.00	1.00	3,298,888.00	17,381,141.00	1.00	172,888.00
	Shpenzime nga të Ardhurat Jashtë Limitit (Kap 04)										
	Totali (Konante + Kapitale + Shpenz. nga të ardh. jashtë limitit)	18,032,301.00	1.00	14,144,000.00	1.00	17,434,000.00	1.00	3,298,888.00	17,381,141.00	1.00	172,888.00
	Numri i punonjësve	7		8		8		0	7		

DREJTORI	Emri	Emëli Shtet
	Firma	
	Data	



Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total - Qendra Kombetare e Veprimtarive Tradicionale Tirane"

Periodha e Raportimit 12-2025

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 603	Art. 604	Art. 605	Art. 606	Total
12	08220	Aktivitetet e fushës së trashëgimisë kulturore (materiale)	2025	Plani fillestar	0	0	6,700,000	1,120,000	2,000,000	0	4,300,000	0	24,000	14,144,000
12	08220	Aktivitetet e fushës së trashëgimisë kulturore (materiale)	2025	Plani i rishikuar	0	0	8,060,000	1,350,000	1,650,000	0	6,300,000	0	74,000	17,434,000
12	08220	Aktivitetet e fushës së trashëgimisë kulturore (materiale)	2025	Shpenzime faktike	0	0	8,056,685	1,342,032	1,548,526	0	6,295,898	0	18,000	17,261,141
12	08220	Aktivitetet e fushës së trashëgimisë kulturore (materiale)	2025		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12		Ndryshimi në vlerë absolute	2025		0	0	3,315	7,968	101,474	0	4,102	0	56,000	172,859
12		Rrealizimi në %	2025		0	0	99.96%	99.41%	93.85%	0	99.93%	0	24.32%	99.01%

Drejtori i Ekspit Menaxhues të Programit	Emri	Erinda Selaj		Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	



Emri i Grupit:		Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit / QKVT		Kodi i grupit		12						
Emri i programit:		Aktivitete te fushes se trashegimise jomateriale		Kodi i programit		08220						
EMËRTIME		Shpenzimet e Programit										
		Viti parashikohet 2024		Perioda raportuese		Perioda raportuese		Perioda raportuese		Perioda raportuese		
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Planit Financiar Vitorit Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Planit Vitorit i Buxhetit Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndërkohësi i planit vitorit	Shpenzime FAKTIKE të Periudhës/Prograsit	Struktura e shpenzimeve në %	Ndërkohësi i planit vitorit (Plan - Fakt)	% e realizimit
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7) (8) (9)	(10)	(11) (12)	(13) (14)	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Kodi i Programit	Emërtimi											
800	Paga	7.752.033.00	48.19%	8.700.000	47.37%	8.000.000	48.23%	1.300.000	8.000.000.00	48.08%	3.310	
801	Sqarime Shqiptare	1.294.071.00	8.05%	1.120.000	7.82%	1.350.000	7.74%	230.000	1.342.032.00	7.77%	7.998	
802	Mallq dhe Shërbime të Tjera	1.524.000.00	9.47%	2.000.000	14.14%	1.850.000	9.48%	350.000	1.548.528.00	8.97%	101.474	
803	Subvencione	0.00	0.00%		0.00%		0.00%	0	0.00	0.00%	0	
804	Transferime Korante të Brendshme	8.500.000.00	34.19%	4.300.000	30.40%	6.300.000	38.14%	2.000.000	6.208.898.00	36.47%	4.102	
805	Transferime Korante të Huaja	0.00	0.00%		0.00%	0	0.00%	0	0.00	0.00%	0	
806	Trans. per Buxh. Fam. & Individ	15.000.00	0.09%	24.000	0.17%	74.000	0.42%	50.000	18.000.00	0.10%	50.000	
	Nëntotali Shpenzime Korante	16.856.104.00	100%	14.144.000.00	100%	17.434.000.00	100%	2.290.000.00	17.281.141.00	100%	172.859.00	
230	Kapitale të Përbuzura	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	
230	Kapitale të Përbuzura	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00%	0.00	0.00	0.00%	0	
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	16.856.104.00	100%	14.144.000.00	1.00	17.434.000.00	1.00	2.290.000.00	17.281.141.00	1.00	172.859.00	
	Shpenzime Korante nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	
	Totali i Shpenzimeve të Programit	16.856.104.00	1.00	14.144.000.00	1.00	17.434.000.00	1.00	2.290.000.00	17.281.141.00	1.00	172.859.00	
Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor												
Artikulli	Emërtimi											
	Totali i Shpenzime Korante	0.00	0.00	14.144.000.00	1.00	17.434.000.00	1.00	2.290.000.00	17.281.141.00	1.00	172.859.00	
Kodi i produktit	Emërtimi											
9122AD	Aktivitete te fushes se trashegimise jomateriale			14.144.000.00	1.00	17.434.000.00	1.00	2.290.000.00	17.281.141.00	1.00	172.859.00	
	Totali Shpenzime per investime	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
9122AD	Aktivitete te fushes se trashegimise jomateriale			0	0	0	0	0	0.00	0	0	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
9122AD	Aktivitete te fushes se trashegimise jomateriale											
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	
9122AD	Aktivitete te fushes se trashegimise jomateriale											
	Total Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	
	Shpenzime korante nga të ardhurat jashtë limitit (Kap 06)	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	
	Totali i Shpenzimeve të Programit	0.00		14.144.000.00		17.434.000.00		2.290.000.00	17.281.141.00		172.859.00	

Drejtori i Elipit Menaxhues të Programit		Enida Selaj		Sekretari i Përgjithshëm		Emri	
		Firma				Firma	
						Data	



RAPORTI 2/1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 12-2025

[illegible]

Drejtori / Ekspert Menaxhues i Programit	Emri	Emri Selaj		Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	



Professi / Eligi Monesthus to Program	Emn	Enide Sany		Emn	
	Fama			Fama	
	Data			Data	



Periudiu e Raportimit: 12-2025

[illegible]

Drafjarski i Dópti Menntaskólinn W. Programmið	Erindi: Sölu
	Fema

	Enrol	
	Firma	
	Data	

[Handwritten signature]



Aneksi 3.2 Deviacioni koston për njësi në vitë

Line Ministry	Program Code	Program Meaning	KPI Target Periodic It	Output Code	Output Meaning	Type Title	2022	2023	2024	2025
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Target Qty	10	7	7	7
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Planned Cost	10,870,000	11,600,000	12,914,080	14,144,000
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Unit Cost (Planned)	1,087,000	1,657,143	1,844,869	2,020,571
					Deviacioni i planit fillestar për njësi gjatë viteve			570,143	187,726	175,703
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Target Qty	10	7	8	7
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Planned Cost	13,048,310	16,274,000	16,085,104	17,434,000
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Unit Cost (Planned)	1,304,831	2,324,857	2,010,638	2,490,571
					Deviacioni i planit te rishikuar për njësi gjatë viteve			1,020,026	-314,219	479,933
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Target Qty	10	7	7	7
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Planned Cost	13,021,627	16,207,855	16,032,301	17,261,141
12	08220	aktivitete te fushese se trashegimise jomateriale		91202AD	Aktivite te fushes s e trashegimise jomateriale, festivali folklorik tipologjik kombetar , promovim libri, ekspozite identitete kombetare, panairi kombetar i arizanall	Unit Cost (Planned)	1,302,163	2,315,408	2,290,329	2,465,877
					Deviacioni i koston faktike për njësi gjatë viteve			1,013,245	-25,079	175,549

Drejtesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Erika Selaj		Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	




ANEKSI nr.4: Raporti i realizimit të treguesve të performances së programit

Periudha e Raportimit 12-2025

Emri i Grupit		Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit/ QKVT		Kodi i Grupit		12			
Emri i Programit		Aktivitete te fushes se trashegimise kulturore jomateriale		Kodi i Programit		09220			
Qëllimi i politikës së programit		Evidentimi, ruajtja, promovimi i studimi dhe percjellja nder breza e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, organizimi i festivaleve folklorike te tipologjive te ndryshme si dhe festivali mbarekombetar i Gjirokastres.							
Treguesit e performancës në nivel qëllimi		Treguesit e performancës/Produktet:							
Kodi i treguesit	Emërtimi i treguesit	Tregues me bare gjnore (PO)	Njësia matëse	Fakti i VRR Paraardhës	Buxheti Vjetor Plan Filluesor VRI 2025	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar VRI 2025	Fakti i Periudhës/ promesive	Ndrrshim (Plan - Fakt)	% e realizimit
912202AD	Aktivtete te fushes s e trashegimise jomateriale, organizim i festivaleve te tipologjive te ndryshme kombetare, festivali barekombetar i Gjirokastres,panaie artizanati e kulinario,ekspozita,workshope etj			16,032,301.00	14,144,000.00	17,434,000.00	17,261,141.00	172,859.00	99.01%
Objektivat e politikës së programit									
Objektivi	Aktivtete te fushes s e trashegimise jomateriale, organizim i festivaleve te tipologjive te ndryshme kombetare, festivali mbarekombetar i Gjirokastres,panaie artizanati e kulinario,ekspozita,workshope etj								
	organizimi i ketyre aktiviteteve sa me mire								
	transmetimi nder breza i folklorit shqiptar								
	ruajtja e elementeve te trashegimise kulturore jomateriale si institucion i vetem kombetar								
	promovimi i trashegimise kulturore								
	botime te ndryshme								
	ekspozita te ndryshme me figura kombetare e kontribute ne folklor								
	workshope ne shkolle								
Produktet									
Kodi i treguesit	Emërtimi i treguesit		Nr. Sherbimesh	0	0	0	0	0	0.00%
		lete		16,032,301.00	14,144,000.00	17,434,000.00	17,261,141.00	172,859.00	99.01%

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Emri	
	Firma		Firma	
	Data		Data	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
QENDRA KOMBETARE EVEPRIMTARIVE TRADICIONALE**

Lënda: Relacion shpjegues mbi plotësimin e tabelave të monitorimit, për 12-mujorin 2025.

RELACION SHPJEGUES

Qendra Kombetare e Veprimtarive Tradicionale, në plotësimin e tabelave të monitorimit për 12 – mujorin e vitit 2025, ka pasur në konsideratë kapacitetet dhe aktivitetin e vet gjatë gjithë periudhës së funksionimit.

Në kuadër të miratimit dhe dërgimit të Buxhetit për vitin 2025, rishikimin e Buxhetit të vitit 2025, si dhe rezultateve të realizimit të buxhetit për vitin 2024 dhe për periudhën aktuale të 2025, janë plotësuar tabelat e monitorimit sipas shpjegimeve si më poshtë:

Aneksi nr.1,-”Raporti i shpenzimeve sipas programeve” për 12 – mujorin e vitit 2025, i cili rezulton me realizimin për vitin 2024 në shumën 16.032.301 lekë.

Konkretisht viti 2024: llog. 600 paga vlera 7.751.371 leke, llog. 601 sigurime shoqerore e shendetesore vlera 1.293.272 leke, llog.602 mallra e sherbime 1.475.131 leke, llog.604 projekte 5.497.527 leke e llog.606 transferta 15000 leke

Buxheti i çelur ne fillim për vitin 2025 është në masën 14.144.000 lekë

Buxheti i rishikuar per 2025 eshte ne masen 17.434.000 leke

Realizimi faktik 12 mujori 17.261.141 leke

Shpenzimet e detajuara janë sipas tabelave bashkëngjitur, në nivel bruto sipas Aneks Nr.1 dhe të detajuara në mënyrë të hollësishme sipas Aneks nr. 1.2.

Aneksi nr.2- “Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivel Programi Buxhetor”, për 12- mujorin e vitit 2025, i cili rezulton me realizim paga, në masën 8.056.685 leke, sigurime në masën 1.342.032 lekë, mallra dhe shërbime nga buxheti, në masën 1.548.526 lekë , dhe Transferta koherente te brendshme, ku llogarisim projektet ne masën 6.295.898 lekë dhe transferta te individet 18.000 leke totali 17.261.141 leke

Për vitin 2025, referuar alokimit të buxhetit fillestar, si dhe ndryshimeve të bëra gjatë periudhës, është bërë shpërndarja sipas zërave përkatësisht:- Llogaria 600-paga, në masën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
QENDRA KOMBETARE EVEPRIMTARIVE TRADICIONALE**

8.060.000 lekë, Llogaria 601 – sigurimet, në masën 1.350.000 lekë, Llogaria 602 - mallra dhe shërbime nga Buxheti në masën 1.650.000 lekë, për transferta te brendshme projekte 6.300.000 leke, transferta te individet 74.000 leke totali 17.434.000 leke

Shpenzimet e detajuara janë sipas tabelave bashkëngjitur, në nivel bruto sipas Aneks Nr.2 dhe të detajuara në mënyrë të hollësishme sipas Aneks nr.2.1.

Aneksi nr.3– “Raporti i performances së produkteve të programit”, për 12 – mujorin e vitit 2025.

Për 12- mujorin e vitit 2025, realizimi i shpenzimeve rezulton të jetë në Llogarinë 600 paga 8.056.685 leke, 601 Sigurime shoqerore e shendetesore, në masën 1.342.032 lekë, në Llogarinë 602 Mallra dhe Shërbime, në masën 1.548.526 leke, llogaria 604 Transfertat e brendshme ku ne realizojme projektet kulturore ne masen 6.295.898 leke, transferta te individe 18.000 leke. Realizimi i shpenzimeve për periudhën raportuese 12- mujori viti 2025 është 17.261.141 lekë.

Shpenzimet e detajuara, janë sipas tabelave bashkëngjitur, në nivel bruto sipas Aneks Nr.3 dhe të detajuara në mënyrë të hollësishme sipas Aneks nr.3.1 dhe 3.2.

Aneksi nr.4 - “Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit” për 12- mujorin e vitit 2025, rezulton me të dhënat sipa tabelës bashkëngjitur në Anksi nr.4, nga 7 aktivitete te planifikuar kemi realizur 7.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE TRADICIONALE

QKVT - RAPORTI I MONITORIMIT

12 – MUJORI - VITI 2025.

Formati standart narrativ i raportit të monitorimit të buxhetit 12 muor 2025

1. Plotësimi i një liste të përmbajtjes së raportit të monitorimit

2. Hyrje

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale është institucion i vetëm shtetëror që merret me veprimtaritë kombëtare në fushën e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale. QKVT, prej vitesh, organizon festivalet kombëtare tipologjike, bazuar në kritere shkencore që i shërbejnë jo vetëm spektaklit, por ruajtjes së origjinalitetit të krijimtarisë popullore. Kohët e fundit nga QKVT organizohen edhe Panairët e Artizanatit dhe Kulinarisë. Nëpërmjet të gjitha veprimtarive përsa me sipër, QKVT synon promovimin dhe ekspozimin e kultures tone kombetare dhe vlerave të saj të patjetërsueshme jomateriale. Kjo realizohet përmes komunikimit direkt dhe në terren me të gjithë bartësit, përçuesit dhe publikun e gjerë pjesëmarrës në veprimtaritë tona.

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale gjatë 12- muorit të vitit 2025 ka zhvilluar dhe është përfshirë në këto aktivitete:

Nr.	Titulli i aktivitetit	Muaji	Vendi
1.	Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit "Një tufë proverbash", një botim anastatik i folkloristit Sotir Kolea.	Shkurt	Tiranë
2.	"Panairi i Punës", Athinë - përfshirja e QKVT	Mars	Athinë
3.	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore.	23-24 Qershor	Lushnjë

4.	Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore Artistike, edicioni VII	10-11 Shtator	Peshkopi
5.	Panairi Kombëtar i Artizanatit , edicioni VI	29 Shtator	Laç
6.	Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë , edicioni XVI	12-13 Dhjetor	Vlorë
Ribotimi anastatik i librit: "Raccolta di Canti Popolari e Rapsodie di Poemi Albanesi", tradotti nell'idioma italiano da Giuseppe Jubany, Albanese. (Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodish të poemave shqiptare, të autorit Zef Jubani)			

Më poshtë gjeni shkurtimisht raportet e këtyre aktiviteteve:

Premiera e dokumentarit dhe promovimin e librit "Një tufë proverbash", një botim anastatik i folkloristit Sotir Kolea.

Në një atmosferë kulturore të mbushur me vlerësim dhe reflektim mbi trashëgiminë kombëtare më datën 12 shkurt 2025 në orën 12.00, u promovua në Bibliotekën Kombëtare, Qendra "Sotir Kolea: Premiera e dokumentarit dhe promovimin e librit "Një tufë proverbash", një botim anastatik i folkloristit Sotir Kolea.

Me rastin e 80-vjetorit të botimit të parë të kësaj vepe, ky event vuri në dukje rëndësinë e punës së Koleas në studimet folkloristike dhe në trashëgiminë kulturore jomateriale, duke theksuar vlerën e tij si një figurë kyçe në historinë intelektuale të Shqipërisë.

Ky aktivitet bëri bashkë akademikë dhe dashamirës të gjuhësisë, folklorit dhe historisë, të cilët nderuan figurën e Koleas. Pjesëmarrësit patën mundësinë të reflektonin mbi trashëgiminë e tij dhe rëndësinë e proverbave të mbledhura në këtë vepër të çmuar. "Një tufë proverbash" është një shembull i mirë i përpjekjeve të folkloristit për të mbledhur dhe ruajtur pasurinë gojore shqiptare, e cila është një burim i pasur për studime të mëtejshme në fushën e folklorit dhe kulturës popullore.

Pas promovimit të librit, të pranishmit patën mundësinë të shihnin premierën e dokumentarit kushtuar jetës dhe veprës së Sotir Koleas, një produksion i realizuar me kujdes për të pasqyruar kontributin e tij në kulturën dhe historinë shqiptare. Dokumentari solli një rrëfim të detajuar mbi

Adresa: Rruga "Bulevardi Zogu I", ndërtesa 7, hyrja 4, apartamenti nr. 8, Tiranë, Shqipëri
Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al

rrugëtimin e tij si folklorist, leksikograf dhe drejtues i Bibliotekës Kombëtare, duke ndriçuar periudha kyçe të jetës së tij, sfidat dhe arritjet që e bënë një figurë të pazëvendësueshme në trashëgiminë tonë kombëtare.

Përmes materialeve arkivore, fotografive dhe dëshmime të studiuesve, dokumentari e portretizoi Kolean si një njeri me vizion të qartë për rëndësinë e ruajtjes së pasurisë gjuhësore dhe folklorike të kombit. Pamje autentike nga dokumentet e shkruara prej tij, si dhe dorëshkrime të ruajtura në Bibliotekën Kombëtare, u shfaqën për të ilustruar përkushtimin e tij të palëkundur ndaj kulturës shqiptare.

Ky dokumentar jo vetëm që ndiçoi veprën e Koleas, por gjithashtu riktheu në vëmendje rëndësinë e përpjekjeve për të dokumentuar dhe promovuar personalitetet që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në kulturën dhe trashëgiminë shqiptare. Përmes këtij promovimi, u riktheu në vëmendje rëndësia e proverbeve shqiptare si një pasuri kulturore e patjetërsueshme, duke nxitur më tej interesin për studimin dhe vlerësimin e folklorit.

“Panairi i Punës”, Athinë - përfshirja e QKVT

Përfshirja e QKVT në Panairin e Punës të organizuar në Athinë kishte për qëllim promovimin dhe prezantimin dinjitoz të trashëgimisë kulturore jomateriale shqiptare përpara publikut ndërkombëtar dhe komunitetit shqiptar në Greqi. Kjo përfshirje synonte forcimin e lidhjeve kulturore me diasporën, si dhe afirmimin ndërkombëtar të vlerave kulturore kombëtare.

Në kuadër të këtij aktiviteti, QKVT përzgjodhi dhe organizoi pjesëmarrjen e tre grupeve artistike tradicionale:

- Grupi Polifonik i Himarës

Prezantoi një program me këngë isopolifonike, të cilat përfaqësojnë trashëgiminë kulturore jomateriale

- Ansambli folklorik “Devolli”

Prezantoi një kolazh vallesh karakteristike nga zona të ndryshme jugore:

- Grupi i Sazeve të Kolonjës

përfaqësoi trashëgiminë muzikore tradicionale të Jugut të Shqipërisë.

Mbështetja financiare që mbuloi QKVT në “Panairin e Punës në Athinë”.

Përpilimin e kontratave për 27 artistë pjesëmarrës.

Pagesën e honorarëve sipas kontratave të lidhura me artistët pjesëmarrës.

Shpenzimet e transportit të artistëve.

Shpenzimet për akomodimin në hotel me tre yje (përfshirë mëngjesin ushqim) për artistët gjatë qëndrimit në Athinë për dt. 01-02.03.2025

Shpenzimet u mbuluan nga buxheti i vitit 2025 i QKVT, konkretisht nga artikulli buxhetor 604 "Projekte kulturore; programi për trashëgiminë kulturore jomateriale".

Artistët sollën me profesionalizëm dhe pasion thesare të trashëgimisë sonë kulturore, duke rritur

"Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Valles Popullore Burimore", edicioni XIII.

Edicioni XIII i Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Valles Popullore Burimore u zhvillua në qytetin e Lushnjës më 23 dhe 24 qershor 2025 dhe mbledhi rreth 300 artistë nga 16 grupe konkurruese përfaqësuese nga Dimal, Klos, Pustec, Lezhë, Fier-Shegan, Gjirokastrë, Dibër, Devoll, Kurbin, "Visaret e Krrabës"-Tiranë, Prrenjas, Finiq, Patos, Tropojë, Vlorë dhe Has, të cilat sollën në skenë hijeshinë dhe fuqinë e valles burimore. Aktiviteti nisi me paradën e grupeve në sheshin kryesor, e cila krijoi atmosferë festive dhe tërhoqi publik të shumtë, dhe vijoi me hapjen zyrtare nga grupi i Lushnjës dhe përshëndetjet e kryetares së bashkisë znj. Eriselda Sefa dhe drejtorit të QKVT z. Niko Kotherja.

Gjatë dy netëve, grupet interpretuese sollën valle, kostume dhe motive tradicionale që mbajtën gjallë trashëgiminë tonë kulturore, ndërsa Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore i Tiranës përshëndeti festivalin me një program të pasur artistik.

Në shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi për kontributin e vyer në trashëgiminë kulturore jomateriale, nga QKVT u vlerësuan me trofe dhe certifikatë "Mirënjohje" dy personalitete të Trashëgimisë tonë Jomateriale

Skënder Haklaj: Për merita të shquara në fushën e etnokoreografisë dhe interpretimit, për përcjelljen e traditës në brezat e rinj dhe kontribut të shquar në shpalljen e "K'cimit të Tropojës" si pjesë e Trashëgimisë Kulturore të Njerëzimit.

Ibrahim Beqo: Për interpretimin mjeshtëror në skenë të Valles Rrajcare, për pjesëmarrje të shquar në veprimtaritë kulturore kombetare dhe përcjelljen e kësaj trashëgimie të vyer koreografike në brezat e rinj.

Në mbyllje, juria e përbërë nga z. Uesli Alushi - kryetar, z. Liman Maloku dhe z. Leonard Syziu shpalli fituesit: Çmimi "Taip Madani" iu dha grupit të valleve të Bashkisë Dibër, Çmimi "Hazir Rustemi" grupit të Qendrës Kulturore të Bashkisë Devoll, Çmimi "Aranit Boraku" Ansambli

“Pjetër Bogdani” Has, Çmimi “Valltari më i mirë” z. Shpresart Memia nga Tropoja, Çmimi “Valltarja më e mirë” znj. Sibora Qendraj nga Ansambli “Krahu i Shqiponjës – Taip Madani” Vlorë, Çmimi “Valltari i ri më i mirë” z. Dionis Pogoni nga Devolli, Çmimi “Koreografia më origjinale” Bashkisë Lezhë, Çmimi “Kostumi më origjinal” Bashkisë Kurbin, Çmimi i Karrierës Bashkisë Prrrenjas dhe Çmimi i Jurisë Qendrës Kulturore “Dardania” Tropojë.

Festivali solli gjallëri në qytetin e Lushnjës, tërhoqi mbi 500 spektatorë dhe përcolli mesazhin e rëndësisë së ruajtjes së vales burimore dhe trashëgimisë sonë kulturore për brezat e ardhshëm.

Festivali Folklorik Kombëtar i Shoqatave Kulturore-Artistike - Peshkopi

Edicioni VII i "Festivalit Folklorik Kombëtar të Shoqatave Kulturore Artistike ", u mbajt më datat 10 dhe 11 shtator në bulevardin “ Elez Isufi” në qytetin e Peshkopisë. Rreth 250 artistë të përfaqësuar nga 10 grupe nga qytete të ndryshme si: Elbasani, Gjirokastra, Tiranë, Belshi, Kamza, Puka, Gramshi, Kelmendi, Dibra dhe Devolli janë bërë së bashku në një aktivitet, që synoi promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë tonë kulturore jomateriale.

Aktiviteti nisi me paradën e grupeve pjesëmarrëse, të cilët sollën atmosferë festive dhe emocionuese në bulevardin kryesor, duke tërhequr vëmendjen e qytetarëve dhe vizitorëve. Parakalimi u shoqërua me muzikë dhe valle popullore, duke krijuar hyrjen e duhur për dy netët e festivalit.

Natën e parë të FFK të Shoqatave Kulturore Artistike, konkuruan këto shoqata:

SHKA “Shpati” - Elbasan , SHKA “Lunxhëria” - Qarku Gjirokastrë, Ansambli “Visaret e Krrabës” – Tiranë, SHKA “Afërdita” – Belsh, Ansambli Artistik “Kaltërsia”- Kamëz.

Ky festival, risolli përsëri në vëmendje vlerën që ka trashëgimia kulturore jomateriale dhe synoi që tek të rinjtë, të trashëgohet arti dhe kultura e tabanit tonë popullor.

Natën e dytë të FFK të Shoqatave Kulturore Artistike, konkuruan këto shoqata:

SHKA “Kçira”- Pukë, SHKA “Sulova” - Gramsh, SHKA “Logu i Bjeshkëve”- Kelmend. Ansambli Artistik “Kuvendi”- Zall Dardhë, Dibër

Grupet pjesëmarrëse në festival, u ngjiten në skenë dhe interpretuan këngët dhe vallet tona popullore, të cilat kanë pasuruar fondin e kulturës shpirtërore shqiptare përmes një krijimtarie të larmishme dhe origjinale të folklorit tonë.

SHKA “Devolli” - Devoll

Grupet pjesëmarrëse në festival, u ngjithën në skenë dhe interpretuan këngët dhe vallet tona popullore, të cilat kanë pasuruar fondin e kulturës shpirtërore shqiptare përmes një krijimtari të larmishme dhe origjinale të folklorit tonë.

Për kontributin e vyer në trashëgiminë kulturore jomateriale, nga QKVT u vlerësuan me Trofe dhe Çertifikatë Mirënjohjeje tre personalitete të Trashëgimisë tonë Jomateriale si:
Përparim Tomçini (pas vdekjes)

Jorgaq Rafti

Për aftësi mjeshtërore në zotërimin e instrumentit klarinetë në formacionet e orkestrinave popullore të Jugut të Shqipërisë dhe jashtë saj, për pjesëmarrjen e gjerë në aktivitetet lokale e kombëtare dhe përgatitjen e instrumentistëve të rinj.

Skënder Lumshi (pas vdekjes)

Për kontribut të çmuar në ekspozimin, përçimin e vlerave dhe repertorin e pasur e origjinal me formacionet folklorike të krahinës së Gramshit, për prezantim cilësor në skenë të pasurive kulturore dhe afishimin e tyre në nivel kombëtar e më gjerë.

Juria profesioniste e përbërë nga specialistë të folklorit:

Znj. Sabrie Nushi – Muzikologe, njëkohësisht kryetare e jurisë

Z. Arian Avrazi – Kompozitor, anëtar

Z. Avni Ndreu – “Nder i Kulturës Dibrane”, Koreograf, anëtar

vlerësoi shoqatat kulturore më çmimet si më poshtë:

Çmimi “Ajdin Leskoviku” – Shoqata Kulturore Artistike më e mirë: SHKA “Devolli”, Devoll

Çmimi “Haziz Ndreu” – Shoqata Kulturore Artistike më e mirë: SHKA “Lunxheria”, Gjirokastrë

Çmimi “Kasem Xhuri” – Shoqata Kulturore Artistike më e mirë: SHKA “Sulova”, Gramsh

Këngëtari më i mirë – z. Marsel Metaj, SHKA “Logu i Bjeshkëve”, Kelmend

Këngëtarja më e mirë – znj. Anxhelina Rustemi, SHKA “Lunxheria”, Gjirokastrë

Valltari më i mirë – Vëllezërit Vasjar dhe z. Flori Hysa, SHKA “Afërdita”, Belsh

Valltarja më e mirë – znj. Emilia Gjata, SHKA “Devolli”, Devoll

Instrumentisti më i mirë – z. Frrok Gjonaj, SHKA “Kçira”, Pukë

Çmimi i Karrierës – SHKA “Shpati”, Elbasan

Çmimi i Jurisë – SHKA “Kuvendi Zall Dardhë”, Dibër

Kostumi popullor më i mirë – SHKA “Logu i Bjeshkëve”, Kelmend

Festivali promovoi më të mirën e kulturës popullore, duke synuar që traditat tona të përcillen nga brezi në brez, të mos harrohen dhe të kultivohen si një pasuri e çmuar e trashëgimisë sonë jomateriale.

Panairi Kombëtar i Artizanatit, Edicioni VI – Laç

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe Bashkinë Kurbin, organizoi më 29 shtator 2025 në qytetin e Laçit edicionin e gjashtë të “Panairit Kombëtar të Artizanatit”, në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore. Aktiviteti u zhvillua në sheshin kryesor të qytetit ora 17:00.

Ky panair kombëtar bëri bashkë rreth 50 artizanë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë si Tirana, Saranda, Tepelena, Kukësi, Laçi, Elbasani, Korça, Erseka, Gramshi, Gjirokastra, Berati, Belshi, Fieri, Rrësheni, Lezha, Kruja, Vlora, Shkodra etj. Artizanët pjesëmarrës ekspozuan një larmi të pasur punimesh tradicionale, si veshje popullore të punuara me dorë, qendistari, qylyma e thurje të ndryshme, punime në dru, punime qeramike, stoli tradicionale, punime me grep dhe shumë produkte të tjera që përfaqësojnë trashëgiminë e gjallë shpirtërore dhe materiale të vendit.

Atmosfera e panairit u karakterizua nga entuziazmi dhe interesimi i madh i banorëve të Laçit dhe vizitorëve të ardhur nga qytete të tjera. Sheshi kryesor i qytetit u mbush me ngjyra, tinguj dhe shije tradite, duke u kthyer në një hapësirë të gjallë ku publiku u njoh nga afër me mjeshtërinë dhe punën e duarartëve.

Pjesë e aktivitetit ishte edhe koncerti folklorik i pasur me këngë e valle popullore, ku u shpalos larushia e traditave nga grupe artistike të ndryshme. Koncerti, i moderuar nga prezantuesi Gent Lasku dhe Eneda Tarifa, e cila performoi edhe vetë në skenë, krijoi një atmosferë festive e plot energji, duke i dhënë panairit dimensionin e një feste kombëtare.

Në skenë, artizania Mimoza Pjetraj ndau përvojën shumëvjeçare dhe foli për përpjekjet që po bëjnë për të trashëguar zanatin tek vajza e saj dhe të rejat e brezit të ri, duke e kthyer artizanatin në një traditë të gjallë që kalon nga një brez tek tjetri.

Panairi Kombëtar i Artizanatit, edicioni VI, dëshmoi se trashëgimia jonë shpirtërore dhe artizanale ka një rol të pazëvendësueshëm në jetën kulturore të vendit. Aktiviteti u shndërrua në skenë madhështore, ku artizanati, muzika dhe tradita u bënë njësh me publikun, duke promovuar vlerat tona kombëtare.

Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Iso-Polifonisë – Vlorë

Edicioni XVI i “Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë” u zhvillua më datat 12–13 dhjetor në sallën e Pallatit të Kulturës “Labëria”, në qytetin e Vlorës. Në këtë aktivitet morën pjesë 17 grupe polifonike nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, të cilat u bashkuan në një ngjarje me rëndësi të veçantë kulturore, kushtuar ruajtjes, promovimit dhe përcjelljes së trashëgimisë kulturore jomateriale të iso-polifonisë shqiptare, pasuri e njohur nga UNESCO si “Kryevepër e Trashëgimisë Gojore dhe Jomateriale të Njerëzimit”.

280 artistë të përfaqësuar nga grupe të qytete të ndryshme si: Gjirokastra, Gramshi, Selenica, Kuçova, Memaliaj, Vlorë Saranda, Kavaja, Lushnja, Piluri, Dropulli, Himara, Skrapari, Delvina etj janë bërë së bashku në një aktivitet, që synoi promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë tonë kulturore jomateriale.

Interpretimet e grupeve konkurruese, të shoqëruara me kostume popullore dhe elementë karakteristike të folklorit, krijuan një atmosferë artistike dhe kulturore të veçantë, duke pasqyruar larminë tipologjike dhe vlerat autentike të traditës polifonike shqiptare.

Ky edicion shënoi rikthimin e festivalit në qytetin e Vlorës pas një mungese 6-vjeçare, duke krijuar pritshmëri të larta për pjesëmarrjen e publikut dhe interesin qytetar.

Grupet pjesëmarrëse në natën e parë ishin:

Grupi polifonik “Djemtë e Lumit të Bardhë”, Selenicë

Grupi polifonik “Shëndëllia”, Mallakastër

Grupi polifonik i Tepelenës

Grupi polifonik “Gurra e Picarit”, Qarku Gjirokastrë

Grupi polifonik i grave të fshatit Sel’o, Dropull i Sipërm

Grupi polifonik “Djemtë e Bogonicës”

Grupi polifonik i QK “Vëllezërit Çetiri”, Gramsh

Grupi polifonik Lab i Memaliajt

Nata e dytë vijoi me interpretimet e grupeve të tjera pjesëmarrëse, duke u karakterizuar nga një atmosferë e qetë, e përqendruar dhe me vlerësim të vazhdueshëm artistik nga publiku i pranishëm.

Grupet pjesëmarrëse në natën e dytë ishin:

Grupi polifonik “Zeri i Bilbilit”, Sarandë

Grupi polifonik “Thesaret Labe”

Grupi polifonik “Jehona Zagorite”

Grupi polifonik i Himarës

Grupi vllah i Kavajës

Grupi polifonik “Nektari i Polifonisë”

Grupi polifonik “Gjergj Arianiti”

Grupi polifonik “Çipini”

Grupi polifonik i Pilurit

Gjatë natës së dytë, festivali u përshëndet gjithashtu nga Ansambli “Lidhja e Prizrenit” nga Kosova, i cili solli në skenë një moment të veçantë artistik, duke pasuruar programin e festivalit dhe duke theksuar lidhjet kulturore mbarëkombëtare. Në shenjë falënderimi, Drejtoresha e QKVT i dhuroi Ansambilit “Lidhja e Prizrenit” një certifikatë mirënjohjeje *“Për pjesëmarrje dhe bashkëpunim të shquar me QKVT në shkëmbimin e vlerave të përbashkëta të Trashëgimisë Sonë Kombëtare, si shenjë e vllazërimit mbarëshqipëtar”*. Znj. Cano i dhuroi ansambilit dhe kopje të botimit anastatit të realizuar nga QKVT me titull “Lyra” të Neço Mukës, si simbol vlerësimi dhe bashkëpunimi kulturor.

Vlerësimi i grupeve pjesëmarrëse u realizua nga një juri profesionale, e përbërë nga personalitete të fushës së etnomuzikologjisë dhe muzikës tradicionale.

Përbërja e juri: Naxhi Kasoruho – Etnomuzikolog, “Mjeshtër i Madh” – Kryetar i juri.

Sejmen Gjokoli – Studiues folklori, “Mjeshtër i Madh”

Agim Rrëza – Kompozitor, muzikolog

Në përfundim të edicionit XVI, u ndanë çmimet e festivalit, të shoqëruara me trofe duke vlerësuar kontributin e grupeve dhe individëve në trashëgiminë kulturore jomateriale.

Çmimet e dhëna në Festivalin Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonisë, edicioni XVI, ishin:

Çmimi “NEÇO MUKO”- Grupi polifonik “Bejke e Bardhë” Pilur

Çmimi - “DEMIR ZYKO”- Qendra Kulturore “Vëllezërit Çetiri”, Gramsh

Çmimi - “XHEVAT AVDALLI”- Grupi polifonik “Jehona Zagorite”

Çmimi - "ARAP ÇELOLESKAJ"- Grupi polifonik "Gurra e Picarit", Qarku Gjirokastrë

Çmimi - "DHIMITËR VARFI" - Grupi polifonik "Zëri i Bilbilit", Sarandë

Çmimi - "Marrësi më i mirë"- Përparim Çunaj, Selenicë

Çmimi - "Marrësja më e mirë"- Katina Beleri, Himarë

Çmimi Inkurajues – Grupi polifonik "Nektari i Polifonisë

- Çmimi i Karrierës - Grupi polifonik i grave të fshatit Selo, Dropull i Sipërm

- Çmimi i Jurisë "LEFTER ÇIPA"- "Ansambli Çipini", Vlorë

Gjatë zhvillimit të festivalit u vu re gjithashtu interes dhe prani e brezit të ri, veçanërisht të rinjve të angazhuar në grupe polifonike dhe dashamirës të trashëgimisë kulturore, çka dëshmon vazhdimësinë dhe përcjelljen ndërbreznore të iso-polifonisë shqiptare.

Ribotimi anastatik i librit:

"Raccolta di Canti Popolari e Rapsodie di Poemi Albanesi", tradotti nell'idioma italiano da Giuseppe Jubany, Albanese. (Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodish të poemave shqiptare, të autorit Zef Jubani)

3. Informacion buxhetor i agreguar

Këto aktivitete u zhvilluan sipas programit Nr 1 Grupi 12 Kapitull 001 kod programi 08220,

Llogaria ekonomike 604, nënlllogaria 6040009, kod projekti 91202 AD.

Premiera e dokumentarit dhe promovimi i librit "Një tufë proverbash", një botim anastatik i folkloristit Sotir Kolea. Shpenzimet e këtij aktiviteti përfshijnë vetëm botimin e librit 100.000 leke.

U shpërndanë 60 libra për të pranishmit.

Për përfshirjen në aktivitetin Panairi i Punes ne Athine u perdoren fondet buxhetore llogaria 604 projekte ne shumen:

Për pagesën e honorareve, shpenzimeve të transportit etj sipas kontratave të lidhura me artistet vlera 709.850 leke

Për pagesën e akomodimit ne hotel me tre yje per dy dite vlera 250.000 leke

Per tatimin ne burim u perdoren fondet e llogarise 602 , nenlllogaria 6022099 vlera 93.150 leke

Gjithsej per kete aktivitet u perdoren 1.053.000 leke.

Adresa: Rruga " Bulevardi Zogu I", ndërtesa 7, hyrja 4, apartamenti nr. 8, Tiranë, Shqipëri
Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al

Ne keto aktivitete pjesmarrja e femrave ka qene prezente , 9 femra moren pjese ne Panairi i Punes ne Athine, nga 27 pjesmarres gjithsej.

Ne FFK te Valles Popullore Burimore ne Lushnje u perdoren fondet nga llogaria 604 projekte ne shumen:

Per marketingun 48.600 leke , per pagesen e trofeve per çmimet dhe mirenjohjet e festivalit 169.000 leke, per shpenzimet e fonise e ndriçimit 285.600 leke, per shpenzimet e ndertimit te skenes 201.600 leke, per realizimin e skenografise me ekrane ledi 190.000 leke, per marrjen e mjetit me qera ne dispozicion te stafit dhe jurise 60.000 leke, per pagesen e jurise 61.200 leke, per skenaristin e festivalit 20.400 leke, per regjisorin 42.500 leke, per moderatoren 25.500 leke, per pagesen e anetareve e komitetit organizativ te festivalit 8.500 leke, per pagesen e kameramanit 30.600 leke (gjithsej festivali i valles 1.143.500 leke). Per realizimin e aktivitetit rendesi te vecante ka dhe mbeshtetja financiare nga Bashkia Lushnje duke mbuluar shpenzimet per akomodimin dhe ushqimin e grupeve pjesmarrese ne aktivitet, pa te cilen do ishte e pamundur te realizohej ky festival.

Në FFK te Shoqatave Kulturore Artistike në Peshkopi u përdorën fondet nga llogaria 604 projekte ne shumen:

Per marketingun 69.600 leke , per pagesen e trofeve per çmimet dhe mirenjohjet e festivalit 197.500 leke, per shpenzimet e fonise e ndriçimit 237.600 leke, per shpenzimet e ndertimit te skenes 214.800 leke, per realizimin e skenografise me ekrane ledi 201.600 leke, per marrjen e mjetit me qera ne dispozicion te stafit dhe jurise 60.000 leke nga llogaria 602, per pagesen e jurise 61.200 leke, per skenaristin e festivalit 20.400 leke, per regjisorin 42.500 leke, per moderatoren 21.250 leke, per pagesen e kameramanit 42.500 leke (gjithsej festivali i SHKA 1.108.950 leke nga 604 dhe 60000 leke nga 602). Per realizimin e aktivitetit rendesi te vecante ka dhe mbeshtetja financiare nga Bashkia Peshkopi duke mbuluar shpenzimet per akomodimin dhe ushqimin e grupeve pjesmarrese ne aktivitet, grupeve pershendetese juri etj pa te cilen do ishte e pamundur te realizohej ky festival.

Në Panairin Kombëtar të Artizanatit në Laç u përdorën fondet nga llogaria 604 projekte në shumen:

Per pagesen e honorarit per artizanët pjesmarrës në panair 547.000 leke, per shpenzimet e fonise e ndriçimit 132.000 leke, per shpenzimet e ndertimit te skenes 95.880 leke, per realizimin e skenografise me ekrane ledi 110.000 leke, per marrjen e mjetit me qera ne dispozicion te stafit

dhe jurise 30.000 leke nga llogaria 602, per pagesen e marketingut 60.350 leke llogaria 602, per moderatoren 21.250 leke (gjithsej panairi 906.130 leke nga 604 dhe 90.350 leke nga 602). Per realizimin e aktivitetit rendesi te vecante ka dhe mbeshtetja financiare nga Bashkia e Kurbinit duke mbuluar shpenzimet per akomodimin dhe ushqimin e artizaneve dhe artisteve pjesmarres ne aktivitet, etj pa te cilen do ishte e pamundur te realizohej ky panair.

Në FFTK të Isopolifonisë në Vlorë u përdorën fondet nga llogaria 604 projekte ne shumen:

Per marketingun 53.600 leke , per pagesen e trofeve per çmimet dhe mirenjohjet e festivalit 148.000 leke, per shpenzimet e akomodimit te grupeve pjesmarrese , përshëndetëse juri, moderator , te ftuar etj 445.200 leke, per shpenzimet e trajtimit me ushqim per dy nete dreke e darke per grupet etj 816.000 leke, per marrjen e mjetit me qera ne dispozicion te stafit dhe jurise 64.188 leke, per pagesen e jurise 61.200 leke, per skenaristin e festivalit 17.000 leke, per regjisorin 42.500 leke, per moderatoren 25.500 leke, per pagesen e kameramanit 42.500 leke, per pagesen e kordinatorit 25.500 leke, për grup përshëndetës 17.000 lekë, për pagesën e çmimeve të festivalit në kuadër të 20- vjetorit të Isopolifonisë në UNESCO 340.680 leke (gjithsej festivali i Isos 2.098.868 leke nga 604). Per realizimin e aktivitetit rendesi te vecante ka dhe mbeshtetja financiare nga Këshilli i Qarkut Vlorë me shpenzimet për foni, ndriçim, ledwall, Bashkia Vlorë nëpërmjet Qendres Kulturore Vlorë na mundësoi vënien ne dispozicion të Pallatit të Kulturës Labëria, pa te cilen do ishte e pamundur te realizohej ky festival.

Për ribotimin anastatik të librit:

"Raccolta di Canti Popolari e Rapsodie di Poemi Albanesi", tradotti nell'idioma italiano da Giuseppe Jubany, Albanese. (Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodish të poemave shqiptare, të autorit Zef Jubani) është shpenzuar 100.000 lekë nga llogaria 602 – Botime.

Numri i punonjësve buxhetore i miratuar në ligjin e buxhetit vjetor është 6 punonjës në organike dhe 2 punonjës me kontratë.

Nr.faktik i punonjësve është 6+1.

Plani fillestar i buxhetit ka qenë 14.144 në mijë lekë.

Plani i rishikuar 17.434 në mije leke.

plani i periudhës 12- mujore është 17.434 në mijë lekë

Në planin e buxhetit përfshihen fondet për të gjitha llogaritë, si paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet për administratën dhe shpenzimet për projektet e transfertat tek individet. Nga ana e MTKS kemi patur mbështetje financiare lidhur me pagat e sigurimet shoqërore dhe projektet pavaresisht çeljes se fondit në fillim viti me diferencë.

4. Performance e Treguesve kyç të performancës me bazë gjinore në nivel produkti

5.1 Performanca financiare e programit buxhetor.

Aktivitetet të Trashëgimisë Jomateriale:

Buxheti Fillestar 14.144 në mijë lekë

Buxhet i Rishikuar 17.434 në mijë lekë

Plani 12 mujor 17.434 në mijë lekë

Fakti 12 mujor 17.261 në mijë lekë

Paga 8.057 në mijë lekë

Sigurime shoqërore 1.032 në mijë lekë

Mallra dhe shërbime të tjera 1.549 në mijë lekë

Projekte 6.296 në mijë lekë

Te tjera transfertat te individet 18 në mijë leke

Investime nuk kemi.

Krahasuar me vitin 2024, buxheti fillestar ka qënë 12.914 në mijë lekë

Buxheti i rishikuar 16.085 ne mije leke

Plani i periudhës 12 mujore 16.085 ne mije lekë

Fakti i periudhës 16.032 ne mije lekë

Paga 7.751 në mijë lekë

Sigurime shoqërore 1.293 në mijë lekë

Mallra dhe shërbime të tjera 1.475 në mijë lekë

Projekte 5.498 në mijë lekë

Te tjera transferta te individet 15 ne mije leke

Investime nuk kemi.

Kemi rritje të shpenzimeve si rezultat i rritjes së pagës dhe sigurimeve shoqërore, projektet etj.

5.2 Performance jo-financiare e programit buxhetor

Aktivitetet e planifikuara nuk u realizuan komplet, per shkak te mos angazhimit te disa bashkive

Objektivat u përmbushën me realizimin e aktiviteteve te tjera, ato qe nuk u realizuan do shtyhen ne kohe e do realizohen patjeter.

Realizimi i objektivit e arriti qëllimin e këtij programi me realizimin e produkteve dhe likuidimin e shpenzimeve.

Kemi nevojë për shtesë si në numër punonjësish ashtu dhe në projekte, paga dhe sigurime shoqërore, kemi derguar prane jush strukturen e re te institucionit dhe presim miratim te saj.

5.3 Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor

Vazhdojmë të punojmë me të njëjtin program buxhetor.

6. Projektet Kapitale

Megjithë kërkesat tona të herëpashershme, QKVT nuk ka arritur të sigurojë projekte kapitale.

7. Ndryshime në buxhet

Nga MTKS u bë shtesa e fondit në llogarinë e pagave, sigurimeve shoqërore, projekte. Dhe kështu u bë e mundur realizimi i gjithë programit vjetor.

8. Përfundime


Bazuar në të dhënat e mësipërme mund të dalim në konkluzionin e përgjithshëm se realizimi i performancës financiare dhe asaj jofinanciare ka qënë në nivel të kënaqshëm.

Të gjithë faktoret pjesëmarrës të brendshëm dhe të jashtëm, falë koordinimit të mirë, kanë luajtur rol pozitiv në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Për arritjen e objektivave dhe realizimin e qellimit që ka institucioni ynë krahas rritjes së fondit buxhetor për paga, sigurime duhet të kemi rritje të fondit për realizimin e projekteve pasi varem edhe nga faktorë të jashtëm si: pjesëmarrja e artistëve në keto projekte, bashkëpunimi me bashkitë, qarqet e ndryshme etj.

DREJTOR

Erilda Selaj



Adresa: Rruga "Bulevardi Zogu I", ndërtesa 7, hyrja 4, apartamenti nr. 8, Tiranë, Shqipëri
Info@folklor.gov.al www.folklor.gov.al